



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

C.nr.284/14

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Lumni Sallauka, me procesmbajtësen Raxhije Emini, në kontestin e paditësit M. B. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, të cilën e përfaqëson Avokati Publik Komunal B. M., me objekt të padisë anulimin e vendimit mbi zgjedhjen e kandidatit dhe kthimin në vendin e punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik, në mungesë të palës së paditur, me datë **25.04.2014**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar, kërkesëpadia e paditësit M. B. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës mbi zgjedhjen e kandidatit nr.01/111-796, dt. 29.03.2001, si dhe të obligohet e paditura Komuna e Prizrenit, që paditësin ta kthejë në detyrat e punës ku ka punuar para hapjes së konkursit, t'ia njoh të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës duke filluar nga data 18.05.2001, e deri në ditën e ekzekutimit të aktgjykimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Shqyrtimi kryesor është mbajtur në mungesë së palës së paditur, konform nenit 423 paragraf 4 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Paditësi M. B., në shqyrtimin kryesor ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së parashtruar, duke shtuar se ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura para vitit 1999, por ka vazhduar punën edhe pas këtij viti në vendin e punës inspektor sanitar ku ka punuar deri më datë 31.03.2001, por gjatë kësaj periudhe ka punuar me kontratë për kohë të caktuar. Para se të skadojë kontrata e fundit, e paditura në shtypin ditor me nr.111-155, ka publikuar konkursin për shumë vende të punës, ndër të tjera edhe për vendin e punës inspektor sanitar për të cilën pozitë ka aplikuar edhe paditësi. Pas intervistimit të paditësit nga ana e komisionit, Bordi i Drejtorëve të Komunës së Prizrenit, me dt.29.03.2001, ka marrë vendimin nr.01/111-796, me të cilin e ka njoftuar paditësin se nuk është pranuar në vendin e punës për të cilin ka konkuruar. Vendimi për shpalljen e këtij konkursi është marrë bazuar në nenin 30/05 e 48/12 të Rregullores 2000/45 dhe nenit 122 e 123 të Model Statutit të Kuvendit Komunal të Prizrenit, i cili nuk mund të konsiderohet si akt ligjor sepse nuk është i finalizuar apo i aprovuar nga ana e Asamblesë Komunale dhe nuk mund të prodhon efekt juridik. Më tutje ka theksuar se përkundër faktit se i ka

plotësuar të gjitha kërkesat apo kriteret e parapara me konkursin e hapur, në vendin e punës inspektor sanitar, është pranuar një kandidat tjetër, i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kriteret, pasi që i njëjti nuk i ka pasur kualifikimet e nevojshme, përvojën e mjaftueshme, ndërsa unë kam qenë në punë për një kohë të gjatë. Si rrjedhojë, ka vlerësuar se komisioni intervistues nuk e ka kryer punën e vet si duhet dhe kandidatin që e kanë pranuar në punë nuk i ka plotësuar kushtet e kërkuara në konkurs, andaj paditësi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë kundër vendimit të lartcekur. Mirëpo Bordi i Drejtorëve të Komunës së Prizrenit me vendimin nr.01/111-854, të dt.09.05.2001, ankesën e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar. Më tutje ka shtuar se kundër vendimit të të paditurës është ankuar edhe në Pushtetin Qendror në Prishtinë, me dt.30.05.2001, e cila ka qenë e obliguar që në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të ankesës të marr vendim, por Autoriteti Qendror një vendim të tillë nuk e ka marrë. Ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit të provave të ofruara të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë si të bazuar, ndërsa shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Përfaqësuesi i të paditurës avokati publik komunal B. M., nuk ka prezentuar në shqyrtimin kryesor, ndërsa në shqyrtimet e mbajtura më herët ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë të cekurave në përgjigjen në padi, me të cilën e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar, me arsyetim se pas luftës në Kosovë janë krijuar rrethana të reja që kanë shtyrë riorganizimin, ristrukturimin dhe sistemimet e reja në vende të punës, sipas nevojës së Komunës, ndërsa kjo është bërë në përputhje me legjislacionin që ka qenë në fuqi, përmes shpalljes publike të konkursit, ndërsa përzgjedhja e kandidatëve i është besuar komisioneve përkatëse, të cilat kanë pasur legjitimitet të plotë për ti përzgjedhur kandidatët dhe këtu nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë shkelje të mundshme. Ka kërkuar nga gjykata që pas administrimit të provave ta refuzoj si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses, ndërsa shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Në këtë drejtim gjykata për vlerësimin e drejtë të kësaj çështje juridike, në seancën e shqyrtimit kryesor, të mbajtur me datë 25.04.2014, ka bërë administrimin dhe vlerësimin e këtyre provave: konkursin nr.111-155, vërtetimin e Drejtorisë së Inspektoriateve të të paditurës nr. 029/41-091, 22-12 nr.0/5113-5 dt.19.02.04, ankesën e paditësit të dt.05.04.01, vendimint ndaj ankesës së paditësit nr.04/5-III-854 e dt.09.05.2001, diplomën e kualifikimit për paditësin, aktvendimin për pushim vjetor të vitit 1999 nr. 122/02 dt. 23.02.1999, procesi i vlerësimit të komisionit për kandidatë të cilët kanë konkuruar në konkurs, diplomat e kundërkandidatëve B. K.1, B. K.2 dhe F. A..

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), udhëzimeve të shëna nga Gjykata e Apelit Ac.nr. 247/13, datë 24.02.2014, si dhe bindjes së lirë të saj, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ashtu që ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është **e pabazuar.**

Nga provat e administruara, gjykata ka vërtetuar se ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishin kontestuese këto fakte: se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të paditura - Komuna e Prizrenit, deri në vitin 2001, në pozitën e punës inspektor sanitar, se në vitin 2000 ka punuar me kontratë pune për kohë të caktuar, pra deri me dt. 31.01.2001, ashtu që ka pranuar të punojë për kohë të caktuar, duke mos e kundërshtuar një gjë të tillë, më pas kur e paditura komuna

e Prizrenit e ka hapur konkursin publik për të gjitha vendet e punës, paditësi ka konkurruar për pozitën e inspektorit sanitar, mirëpo pas intervistimit të mbajtur nga paneli përkatës intervistues, ky i fundit ka konstatuar se paditësi nuk e ka kualifikimin përkatës dhe nuk i ka plotësuar kushtet e caktuara në konkurs, prandaj edhe nuk zgjidhet në pozitën në të cilën ka konkurruar. Më pas paditësi ushtron ankesë pranë të paditurës, ndërsa me vendimin e Bordit të Drejtorëve me nr.01/111-854, të dt.29.03.2001, refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit. Pas kësaj paditësi e ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës e cila i mundësohet sipas këshillës juridike të këtij vendimi, paditësi në kuptim të nenit 35 pika 3 dhe 4 të Rreg.2000/45, ka shfrytëzuar të drejtën e ankesës dhe iu ka drejtuar Autoritetit Qendror në Prishtinë, i cili ka qenë i detyruar që të vendos lidhur me ankesën në afat prej 30 ditëve, nga pranimi i kësaj ankese. Po ashtu sipas nenit 36 të Rregullores së lartcekur, është paraparë se qytetari mund të kërkojë zgjidhje për vendimet e ndonjë komune në pajtim me rregullat dhe procedurat e gjykatës përkatëse.

Kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishin këto fakte: faktin se e paditura a ka pasur bazë ligjore për hapjen e konkursit nr.111-155, si dhe faktin se me rastin e përzgjedhjes së kandidatit për vendin e punës inspektor sanitar, e paditura a i ka respektuar të gjitha kushtet dhe kriteret e parapara me këtë konkurs, më saktësisht vendimi i komisionit intervistues për përzgjedhjen e kandidatit për pozitën e lartcekur a ka qenë i ligjshëm.

Nga provat e lartpërmendura, gjykatës i rezultoi se pretendimi i paditësit se e paditura nuk ka pasur bazë ligjore për hapjen e konkursit të lartcekur nuk qëndron, për faktin se Komuna e Prizrenit, por edhe komunat tjera si subjekte juridike janë themeluar pas përfundimit të luftës në Kosovë të vitit 1999, më saktësisht me Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45, nga e cila rregullore rezulton se Komuna e Prizrenit (tani si e paditur) nuk është suksesore juridike e ish Komunës së para vitit 1999, por është subjekt i veçantë juridik, i cili ka pasur dhe ka të drejtë ligjore që të bëjë organizimin, sistemimin e punëtorëve në vende të ndryshme të punës, gjithmonë bazuar në konkursin e shpallura publikisht, siç është edhe rasti me paditësit. Në këtë përfundim gjykata erdhi edhe nga fakti se paditësi asnjëherë nuk e ka kundërshtuar shpalljen e konkursit të lartcekur, por ka pranuar të aplikojë si të gjithë kandidatët tjerë, ndërsa tek pas shpalljes së rezultateve të shpallura nga e paditura dhe pas marrjes së informacionit se i njëjti nuk është përzgjedhur, inicion procedurën gjyqësore për anulimin e vendimit nr.01/111-796, dt.29.03.2001, ashtu që paditësi me dt.09.05.2001, merr përgjigje nga Bordi i Drejtorëve të komunës së Prizrenit lidhur me ankesën e tij kundër vendimit nr.01/111-796, të dt.29.03.2001, në të cilin thuhet se refuzohet si e pabazë ankesa e paditësit, pasi që pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës nga komisioni intervistues (të përbërë nga dy drejtor vendor dhe një zyrtar ndërkombëtar) dhe i miratuar edhe nga Bordi i Drejtorëve të komunës së Prizrenit, paditësi për vendin e punës inspektor sanitar nuk ka poseduar kualifikimin e duhur dhe nuk i ka plotësuar kushtet e kërkuara me konkurs, prandaj edhe nuk është zgjedhur në pozitën në të cilën ka konkurruar. Gjykata pas vlerësimit të provave të cilat janë përmendur më lartë nuk gjeti ndonjë shkelje të kryer nga e paditura me rastin e përzgjedhjes së kandidatëve për pozitën e inspektorit sanitar, e të cilat do të kishin si pasojë edhe anulimin e vendimit për përzgjedhjen e tyre dhe eventualisht obligimin e të paditurës që të rizgjedhë kandidatët në bazë të konkursit të publikuar.

Si rrjedhojë, gjykata në bazë të provave të administruara dhe të ofruara nga palët ndërgjyqëse, veçanërisht provave të cilat i ka elaboruar më lartë, e që kanë të bëjnë me faktin se gjatë vitit 2000, paditësi ka punuar me kontratë pune në afat të caktuar, ndërsa me hapjen e konkursit publik, i njëjti ka konkurruar sikurse të gjithë kandidatët tjerë, ndërsa në këtë pozitë janë pranuar kundërkandidatët të cilët kanë fituar më shumë poena, edhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit në raport me Komunën e Prizrenit është e pabazuar, pasi siç e cekëm më lartë është e drejtë diskrecionale e të paditurës - komunës së Prizrenit që në marrëdhënie pune ta pranoj atë person për të cilin mendon se i plotëson më së miri kushtet të cilat i ka përcaktuar me konkurs, sigurisht duke i respektuar të gjitha kriteret e përcaktuara dhe procedurën e paraparë me ligjet përkatëse.

Gjykata e refuzoi pjesën e kërkesëpadiisë së paditësit me të cilën ka kërkuar kthimin në vendin e punës në të cilin ka punuar para shpalljes së konkursit kontestues dhe pagimin e të ardhurave personale, për shkak se në kontestet me të cilat kërkohen anulimi i konkursit dhe vendimit mbi zgjedhjen e kandidatit, gjykata ka të drejtë ligjore (nëse gjenë shkelje) vetëm të detyroj të paditurën që të rishpall konkursin, apo ti rivlerësoj të gjithë kandidatët të cilët kanë aplikuar për vendin e caktuar të punës, duke i respektuar të gjitha kriteret ligjore, por jo edhe ta detyrojë atë që ta kthejë paditësin në vendin e mëparshëm të punës, para hapjes së konkursit, pasi në konteste të tilla gjykata me vendimin e saj nuk krijon vende pune, por është punëdhënësi që në bazë të nevojave të tij përcakton vendet e punës. Ndërsa siç e kemi cekur më lartë me vet faktin se paditësi ka pranuar të punoj me kontratë pune në kohë të caktuar deri në hapjen e konkursit, e pas hapjes së tij ka pranuar të konkurroj sikur të gjithë kandidatët tjerë, atëherë ai nuk mund ti referohet vendimit të mëparshëm me të cilin ka krijuar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar dhe nuk mund të kërkojë kthimin në vendin e mëparshëm të punës.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450 të LPK-së, pasi që palët nuk i kanë kërkuar të njëjtat.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C.nr.284/14, datë 25.04.2014

Procesmbajtësja,
Raxhije Emini

Gjyqtari,
Lumni Sallauka

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.

Vërejtje:

Ky aktgjykim të përkthehet në gjuhën boshnjake dhe ti dorëzohet palëve.